



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.230, datë 16.09.2022

PËR
“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Elion Mustafaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
2. Zoti Elion Mustafaj do të ushtrojë detyrën si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, përkohësisht nga data 24.09.2022 - 23.09.2023.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Elion Mustafaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
4. Gjatë periudhës së transferimit zoti Elion Mustafaj do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 20%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.09.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

Anëtar

Sokol Stojani

ANËTAR

Eloida Goxhi

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR

Nurhan Seiti

ANËTAR

Zeqir Hoda